



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia. Org. Org. Jedinë. Org. Unit	02	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	163
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	31.05.2022
Prishtinë / a			



BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - BKS  
KOSOVSKI URED OSIGURANJA - KUO  
KOSOVO INSURANCE BUREAU - KIB

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

Nr. 469/22 Dt. 31.05.22  
PRISHTINË

ndërmjet

BYROSË KOSOVARE TË SIGURIMIT

dhe

AKADEMISË SË DREJTESISË

“PËRFSHIRJA NË KURRIKULËN E TRAJNIMIT TË GJYQTARËVE - ASPEKTET E TRAJTIMIT TË RASTEVE NGA KONTRATAT E SIGURIMIT”

Prishtinë,  
31.05.2022

## Palët

Ky Memorandum Mirëkuptimi lidhet në mes të Akademisë së Drejtësisë dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit.

### Fusha e veprimit

Përmes këtij memorandumi, Byroja Kosovare e Sigurimit do të bashkëpunoj me Akademinë e Drejtësisë në kuadër të programeve të trajnimeve për gjyqtarë që organizon Akademia, të përfshihen edhe temat nga fusha e sigurimeve, respektivisht trajtimit të kërkesave për kompensimin e dëmeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit për të gjitha produktet e sigurimit të njohura sipas ligjit.

### Bashkëpunimi në zbatimin e memorandumit

1. Byroja Kosovare e Sigurimit do t'i propozojë Akademisë së Drejtësisë ekspert të njohur e të dëshmuar vendorë e ndërkombëtarë, me përvojë shumëvjeçare në fushën e sigurimeve të cilët pas aprovimit të tyre nga AD-së do të shkëmbejnë me gjyqtarë, njohuritë e tyre profesionale të përfituara në fushën e përshkruar në nenin 1 të këtij memorandumi.
2. Akademia e Drejtësisë zotohet që në kuadër të kurrikulës dhe pas aprovimit të saj për trajnimin e gjyqtarëve, do të përfshijë orët e caktuara për trajnim nga ekspertët e propozuar/angazhuar nga Byroja Kosovare e Sigurimit.
3. Programi i trajnimit dhe temat të cilat do të trajtohen nga ekspertët e propozuar nga Byroja Kosovare e Sigurimit, do të shqyrtohen dhe aprovohen nga Akademia e Drejtësisë.
4. Ekspertët e caktuar, do të ofrojnë përvojat më të mira dhe praktikat gjyqësore të vendeve të rajonit, të cilat kanë legjislacion të përafërt me legjislacionin vendor që rregullojnë fushën e detyrimeve dhe kontratave të sigurimit në veçanti.
5. Palët vlerësojnë si të dobishme lidhjen e këtij memorandumi të bashkëpunimit si më sipër, ashtu që të njëjtat përmes këtij dokumenti do të përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve të cilat rrjedhin nga kjo.

### Ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve përmes trajnimeve

1. Palët sipas këtij memorandumi të bashkëpunimit pajtohen që përmes ofrimit të trajnimeve profesionale t'i avancojnë njohuritë specifike për sigurimet dhe kontratat e sigurimeve për gjyqtarët, prokurorët dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe profesionistëve tjerë në bazë të vlerësimeve të AD-së të punësuar në sistemin gjyqësor.

S.M.

EA

2. Njohja me përvojat më të mira të trajtimit të kërkesave për shpërblimin e dëmeve të vendeve të rajonit dhe më gjerë. Mbrojtja sa më të mirë të të drejtave të palëve të dëmtuara/palëve të treta/të siguruarve në aksidente të komunikacionit rrugor, të cilat të drejta burojnë nga kontratat e sigurimit.

### Komunikimi në mes të partnerëve

1. Palët do të komunikojnë përmes personave të autorizuar. Në rast të ndërrimit të personit zyrtar, Byroja Kosovare e Sigurimit dhe Akademia e Drejtësisë do të njoftojnë njëra tjetrën pa vonesë për të siguruar implementimin e vazhdueshëm të këtij memorandumi.
2. Komunikimi do të bëhet përmes postës elektronike të personave të autorizuar apo shkresave fizike.
3. Sipas vlerësimit të palëve, me pajtimin paraprak të tyre ato mund të pajtohen që për raste të caktuara mund të aranzhojnë takime të përbashkëta shumë palëshe për të trajtuar detaje të rasteve specifike, vetëm atëherë kur kjo është e domosdoshme.

### Kohëzgjatja

Ky memorandum bashkëpunimi lidhet në afat të pacaktuar, në respektim të plotë të parimeve më të mira për zbatimin e legjislacionit në fuqi. Për çdo mosmarrëveshje eventuale e cila mund të paraqitet ndërmjet kompanive të sigurimit/ Byrosë Kosovare të Sigurimit dhe Akademisë së Drejtësisë, palët do ta zgjidhin miqësisht. Kur zgjidhja nuk është e mundur, palët do të rivlerësojnë vazhdimin e zbatimit të këtij memorandumi.

### Hyrja në fuqi


Ky memorandum nënshkruhet nga palët në tri (2) kopje në gjuhën shqipe dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Byroja Kosovare e Sigurimit

  
Sami Mazreku  
Drejtor Ekzekutiv



Akademia e Drejtësisë

  
Enver Fejzullahu  
Drejtor Ekzekutiv

